



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



04/ 4298 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN MARS 2026

Hani i Elezit, 2026

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin Mars 2026, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësiwe, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit Mars 2026 kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale për muajin Shkurt 2026,
- Barazimi me Thesar periudha Janar-Shkurt 2026,
- Është dërguar për publikim borxhi publik i muajit Shkurt 2026 në ueb faqen komunale,
- Përgatitja dhe publikimi i raportit të punëve dhe aktiviteteve të muajit Shkurt 2026, në dy formate: Word dhe PDF,
- Hartimi i raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit Shkurt 2026,
- Përgatitja dhe dorëzimi i lëndëve të kërkuara nga DAB-MFPT dhe ZKA,
- Plotësimi i një pyetëtori nga Divizioni i Auditimit të Brendshëm – MFPT,
- Publikimi i Raportit Financiar janar-dhjetor në web faqe të komunës në tri formate: Word, PDF dhe Excel,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN MARS 2026

Kategoritë ekonomike të shpenzimeve	Realizimi Mars 2026
Paga dhe shtesa	406,708.29
Mallra dhe shërbime	27,040.01
Shpenzime komunale	944.90
Subvencione dhe trans.	25,089.00
Shpenzime kapitale	-
TOTAL	459,782.20

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2026 është në shumë prej 356,720.00 €. Inkasimi i të hyrave për muajin Mars është në shumë prej 7,712.65 €.

- Poashtu, të hyrat indirekte për TM1 2026, nga gjobat në trafik janë në shumë prej 25,270.00 € dhe 392.48 € nga Agjensioni Pyjor i Kosovës,
- Plotësimi i Projeksionit të të hyrave vetanake 2027-2029 dhe dërgimi në Departamentin e Buxhetin – MFPT,
- Përgatitja e kërkesës për alokimin e të hyrave të inkasuara të muajit janar dhe shkurt në kategorinë buxhetore subvencione dhe transfere në shumë prej 18,034.94 €.
- Regjistrimi, harmonizimi i të hyrave ditore në SIMFK.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka kryer shërbime të rregullta ndaj qytetarëve, siç janë:

- Lëshimin e faturave të tatimit në pronë,
- Lëshimin e vërtetimeve për qëllime të ndryshme.

Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

L. Ballazhi

